L I G J
Nr. 8714, datë 15.12.2000

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 7928, DATË 27.4.1995 "PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", ndryshuar me ligjet nr. 8070, datë 15.2.1996; nr. 8126, datë 9.7.1996; nr. 8130, datë 22.7.1996; nr. 8149, datë 11.9.1996; nr. 8160, datë 7.11.1996; nr. 8186, datë 23.1.1997; nr. 8201, datë 20.3.1997; nr. 8240, datë 16.9.1997; nr. 8445, datë 21.10.1999, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 26 pas paragrafit të dytë shtohet ky paragraf me këtë përmbajtje:

"Për makineritë dhe pajisjet që importohen për t'u investuar në fushën e prodhimit, të ndërtimit dhe të telekomunikacioneve, zbatohet sistemi i shtyrjes së pagesës së TVSH-së. Sipas këtij sistemi, TVSH-ja nuk paguhet në doganë në çastin e importit. Këshilli i Ministrave përcakton skemën e shtyrjes së pagesës.

Neni 2

Në nenin 50, pas pikës 3 shtohen pikat 4 dhe 5, me këtë përmbajtje:

"4. Eksportuesit kanë të drejtë të kërkojnë rimbursim kur teprica e tyre tejkalon shumën 400 000 (katërqind mijë) lekë.

Organet tatimore bëjnë rimbursimin e tepricës kreditore të TVSH-së për këtë kategori tatimpaguesish, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës.

5. Këshilli i Ministrave përcakton kategorinë e eksportuesve të përmendur në pikën 4 të këtij neni".

Neni 3

Neni 53 ndryshohet si vijon:

"a) Kur organet tatimore bëjnë një rimbursim të TVSH-së për një person, në bazë të nenit 52 ata paguajnë interesa për shumën e rimbursimit, sipas përqindjeve të përcaktuara në nenin 49, vetëm kur rimbursimet bëhen më vonë se një vit pas datës kur personi ka paguar TVSH-në, të cilat llogariten nga data kur vendimi gjyqësor ka marrë formën e prerë deri në datën e rimbursimit.

b) Kur organet tatimore nuk bëjnë rimbursimin e TVSH-së, të kërkuar nga tatimpaguesi në afatet e përcaktuara në nenin 50 të këtij ligji, ato paguajnë interesa për shumën e rimbursimit, sipas përqindjeve të përcaktuara në nenin 49".

Neni 4

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2849, datë 26.12.2000 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani